

E DREJTA PËR INFORMIM

Shqipëria merr drejtimin e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit




Shqipëria ka marrë Presidencën e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), detyrë të cilën do ta mbajë deri në qershor 2025. Në takimin e fundit të Komitetit Ekzekutiv të Komisionerëve të Informimit (ICIC) u vendos që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zoti Besnik Dervishi, të drejtojë këtë organizatë.

Përmes një njoftimi, Komiteti e ka informuar zotin Dervishi për rolin e ri që i është besuar, duke shprehur vlerësimet më të larta për kapacitetin dhe profesionalizmin e spikatur gjatë këtyre viteve. Presidencën e ICIC, ku aderojnë mbi 90 vende nga e gjithë bota, e ka mbajtur më herët Autoriteti Meksikan për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (INAI).

Konferenca Ndërkombëtare u mbledh për herë të parë në vitin 2003, ndërsa e fundit që mikpritë dhe edicionin e 15-të të saj ishte Shqipëria, në qershor të vitit të shkuar. Gjermania do të jetë vendi organizator i takimit të rradhës, që parashikohet të zhvillohet në Berlin në muajin qershor.

Kjo Konferencë ka si qëllim të nxisë mbrojtjen dhe promovimin e aksesit në informacionin publik si një shtyllë themelore për qeverisjen sociale, ekonomike dhe demokratike, ndarjen e njohurive dhe praktikave më të mira, të krijojë kapacitete, të ndihmojë në identifikimin e asaj që nevojitet për përparimin global dhe të veprojë si një zë i përbashkët në forumet ndërkombëtare me synimin për të përmirësuar të drejtën e qytetarëve për informacion publik.



Tryezë diskutimi me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat



Zyra e Komisionerit zhvilloi takimin e përvitshëm me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe medias investigative. Në fokus të tij ishte pasqyrimi i veprimtarisë së institucionit përgjatë vitit 2024 dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe medias në kuadër të shtimit të përpjekjeve për konsolidimin e kulturës së llogaridhënies dhe transparencës së autoriteteve publike.

Gjatë fjalës së tij, z. Dervishi bëri një bilanc të punës dhe arritjeve të Zyrës së Komisionerit, duke e konsideruar një moment të rëndësishëm mbajtjen e Konferencës VI Kombëtare për të Drejtën e Informimit, në qershor 2024, e cila sipas tij shënoi nisjen e një momenti të ri bashkëpunimi me autoritetet publike, në funksion të transparencës dhe luftës kundër korrupsionit. Në këtë kuadër, ai përmendi ngritjen dhe funksionimin e platformës “Transparent Albania”, si një mjet që promovon llogaridhënien dhe ofron informacion të plotë mbi veprimtarinë e autoriteteve publike.

Komisioneri u shpreh se gjatë vitit 2024, institucioni ka administruar 1025 ankesa, ku për 616 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve, pas ndërhyrjes së institucionit që ai drejton. Z. Dervishi bëri të ditur se ankesat janë paraqitur nga qytetarë, përfaqësues të medias, të shoqërisë civile, përfaqësues ligjorë, etj.

Gjithashtu, Komisioneri u ndal edhe te prezantimi i raportit paraprak “Mbi vlerësimin bazë për zbatimin e Konventës të Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare nga Shqipëria”, duke theksuar se forcimi i transparencës së autoriteteve publike nëpërmjet zbatimit të praktikave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare është rruga e duhur për përfshirjen e publikut në qeverisje, duke shërbyer edhe si nxitje për ushtrimin e kësaj të drejte nga qytetarët.

Drejtoresha e Përgjithshme e të Drejtës për Informim znj. Elona Hoxhaj, tha se vlerësimi i Grupit të Ekspertëve lidhur me zbatimin e Konventës të Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentet Zyrtare nga Shqipëria është në përgjithësi shumë i mirë. Ndërsa në lidhje me analizën për vlerësimin e ndikimit në transparencë për autoritet publike duhet mbajtur parasysh nevoja për rritjen e kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit për të bërë këto monitorime të thelluara.



Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe medias investigative vlerësuan punën dhe angazhimin e Zyrës së Komisionerit, si edhe diskutuan mbi problematikat apo vështirësitë që hasin gjatë punës së tyre në sigurimin e informacionit nga autoritetet publike. Ata sugjeruan se krahas forcimit të kulturës së transparencës, duhen gjetur mekanizma shtesë për të thjeshtuar dhe për të bërë sa më të zbatueshëm ligjin, në mënyrë që autoritetet të jenë sa më efikase në dhënien e informacionit të plotë dhe në kohë.

Komisioneri Dervishi takon Ambasadorin Gonzato, ligji për mbrojtjen e të dhënave përparim i rëndësishëm drejt BE

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, priti në një takim zyrtar Ambasadorin e Bashkimit Evropian në Tiranë, z. Silvio Gonzato. Në takim u diskutua mbi progresin e bërë nga Shqipëria në fushat e veprimtarisë që mbulon institucioni, si në atë për të drejtën e informimit dhe të dhënat e hapura, ashtu edhe në atë për mbrojtjen e të dhënave personale.



Zoti Dervishi e falenderoi Ambasadorin Gonzato për mbështetjen e pakursyer që Bashkimi Evropian ka dhënë ndër vite dhe në veçanti për ekspertizën përgjatë procesit të harmonizimit të plotë të ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale” me Rregulloren e Përgjithshme Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR).

Ai theksoi se sfidë për Zyrën e Komisionerit mbetet zbatimi i plotë i legjislacionit të modernizuar, nevoja për mbështetje me kapacitete profesionale, dhe veçanërisht ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe kontrolluesve publikë e privatë me risitë e këtij akti rregullator, si dhe rritja e kulturës së mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga ana e tij Ambasadori Gonzato vlerësoi punën e deritanishme të Zyrës së Komisionerit, duke shprehur angazhimin e tij të plotë për mbështetjen e këtij institucioni në përmbushjen dhe realizimin e objektivave në të ardhmen.



Komisioneri Dervishi dhe Ministri Gonxhja nënshkruajnë udhëzimin “Për licensën standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik”

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, ka nënshkruar udhëzimin e përbashkët me Ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Blendi Gonxhja “Për miratimin e licensës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik”.

Ky udhëzim vjen në mbështetje të nenit 11, pika 2 dhe nenit 22, pika 2, të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.



Miratimi i licensave për ripërdorimin e të dhënave të hapura në Republikën e Shqipërisë është i njëjtë me standardet e Bashkimit Evropian dhe i përkasin familjes së licensave *Creative Commons CC*. Këto licensa do të ofrojnë siguri juridike në mënyrë që informacionet të përdoren lirisht nga të gjithë, me kushtin kryesor që burimi i të dhënave të citohet sipas kërkesave të tyre. Po ashtu, këto licensa do të jenë në format elektronik dhe do të shoqërojnë informacionin që do të publikohet nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike në faqet e tyre zyrtare dhe në portalin e të dhënave të hapura, opendata.gov.al.

Me hyrjen e tij në fuqi, Udhëzimi do të jetë i zbatueshëm nga organet e sektorit publik, sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:

